

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Bujqësia ka humbur mbi 300 milionë euro ndihma"/ Meta: Ky është shqetësimi i shqiptarëve, jo pagat e gjyqtarëve
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/bujqesia-ka-humbur-mbi-300-milione-euro-ndihma-meta-ky-esh-te-shqetesi-i474021
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:12:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 12:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	216f38e3b60a10c6b8f991848137ab2a75866d213c33bbfef6a77b7df795f8fe
TEKSTI	db0cc959ca97d298d515ac5b7f51727a26a159a30a248f1f47a8ea664f0f7d86
PAMJA	e24d8af6b7f3f6d90a00f6c9f52f045a92acd9ee771576a7bd7a435b3a31e4b7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a32a97eadba274cce3c999d30160cb037f6aa335cabd0592b86dbf41ac56ab7c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a32a97eadba274cce3c999d30160cb037f6aa335cabd0592b86dbf41ac56ab7c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

“Bujqësia ka humbur mbi 300 milionë euro ndihma”/ Meta: Ky është shqetësimi i shqiptarëve, jo pagat e gjyqtarëve



13 Shtator 2026, 14:54, Aktualitet CNA



Kryetari i Partisë së Lirisë, Ilir Meta ka bërë një reagim në rrjetet sociale lidhur me çështjen e pagave të sistemit të drejtësisë.

Meta nga burgu shkruan se shqetësimi i shqiptarëve nuk është pse prokurorët dhe gjyqtarët në Shqipëri marrin 500 euro më shumë se kolegët e tyre në Greqi.

Sipas tij, shqetësimi madhor është pse nuk veprojnë si kolegët e tyre në Greqi, sidomos kur bëhet fjalë për abuzimin dhe vjedhjen e fondeve të BE-së për bujqësinë, përmes skemës IPARD.

Meta shprehet se bujqësia shqiptare ka humbur mbi 300 milion euro ndihma, dhe thekson se ky është shqetësimi i vërtetë i shqiptarëve dhe jo sa paguhet një gjyqtar apo një prokuror.

Postimi i plotë:

Shqetësimi maanor i qytetareve shqiptare nuk esnie pse prokurori ane gjyqare ne shqiperi marrin 500 euro me shume ne page se koleget e tyre ne Greqi.

Shqetësimi madhor është pse nuk veprojnë si kolegët e tyre në Greqi, sidomos kur bëhet fjalë për abuzimin dhe vjedhjen e fondeve të BE-së për bujqësinë, përmes skemës IPARD.

Në Greqi, përballë dyshimeve për abuzime me fondet europiane, pati mbi 37 arrestime të zyrtarëve të lartë dhe u hoqën 13 imunitete parlamentare të partisë në pushtet, duke i hapur rrugën drejtësisë për hetime të plota dhe shteruese, pavarësisht se Greqia e mbështet bujqësinë në mënyrë të jashtëzakonshme nga buxheti i shtetit.


Ndërsa në Shqipëri, për të tretin vit radhazi, fondet IPARD të BE-së për fermerët mbeten të bllokuara.

Bujqësia shqiptare ka humbur mbi 300 milion euro ndihma, ndërkohë që përgjegjësitë penale, institucionale dhe politike vazhdojnë të mbeten pa një përgjigje të qartë nga drejtësia sepse Edi Rama i ka bllokuar qëllimisht hetimet.

Ky është shqetësimi i vërtetë i shqiptarëve sot.

Jo sa paguhet një gjyqtar apo një prokuror.

Por nëse drejtësia është vërtet e pavarur dhe e gatshme, jo vetëm të hetojë dhe të ndëshkojë, por edhe të parandalojë vjedhjen e parave të shqiptarëve, dëmet kolosale që u shkaktohen fermerëve shqiptarë si në rastin e fondeve IPARD, aferat e panumërta që gllabërojnë qindra milion euro, përfshi dhe grabitjen e fondeve ndihmë të Bashkimit Europian. /CNA





Të sugjeruara

[Goli 8.6 milionë dollarë i Ron Yeffet edhe me këmbën e narkogjatësisë?](#)

[Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë](#)

[E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepiskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi](#)

[Përplasja për pagat e magistratëve/ Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën](#)

[Shuhen vatrat e zjarrit në të gjithë vendin](#)

[Gjergj Luca, sipërmarrësi që ngre qytete/ Fish City Apollonia, një ëndërr e bërë realitet](#)

["Një situatë e tillë nuk është parë në botë"/ Pacolli: Aeroporti i Vlorës nuk duhet të mbetet peng i interesave të askujt](#)

[VIDEO/ Rrethohet Kryeministria, protestuesit zhvendosen në hyrjen e pasme të godinës](#)

[Zjarret dhe përmbytjet në vend/ Ministria e Mbrojtjes përditësimet për situatën](#)

[Deputeti i PD-së nën hetim nga SPAK/ Këlliçi: Interesi i Ramës kërkon përndjekje të opozitës](#)

[FOTOLAJM/ Pankartat në protestën e 105-të kundër qeverisë, mesazhet e diasporës](#)

Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Nis protesta e 105 kundër qeverisë

Përplasjet për çështjen e pagave/ Gjyqtari Pëllumbi: SPAK mund të hetojë çdo person ndaj të cilit ka dyshime

105 ditë protestë kundër qeverisë/ Diaspora zbarkon në Tiranë

28 vjet nga vrasja e Azem Hajdarit/ Këlliçi: Vizioni dhe guximi e vendosën në krye të lëvizjes së dhjetorit

Çështja e pagave të drejtësisë/ Meta: Konflikt i provokuar nga Rama

CNA merr pjesë në IBC 2026/ Ngjarja kryesore e teknologjisë mediatike në Europë

Moti i keq përfshin qarkun e Elbasanit/ Përmytën rrugët, vështirësi në qarkullim

Reshjet e shiut fikin zjarret/ Vetëm një vatër aktive


Trafiku i drogës nga Kolumbia/ Hita: Janë arrestuar disa shtetas shqiptarë, njëri prej tyre i dënuar për vrasje

[editorial](#)

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.